

المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ



المؤسسة الإسلامية للشباب

Në emër të All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

Fondacioni i Rinisë Islame

Stiftung der Islamischen Jugend

Foundation of Islamic Youth

ÇDO TË THOTË PËRKATËSIA IME NË ISLAM

Fet'hi Jeken

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

Botuar nga: Furkan ISM

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë botuesit

www.islamischen.ch
✉ islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

Ç'DO TË THOTË PËRKATËSIA IME ISLAME 5
TË JEM MUSLIMAN NË BESIMIN TIM 6
TË JEM MUSLIMAN NË IBADETIN TIM 11
TË JEM MUSLIMAN NË AHLAKUN TIM 13
TË JETOJ VETËM PËR ISLAMIN 17
TË BESOJ SE PUNA PËR ISLAMIN ËSHTË OBLIGIM 22
TË BESOJ SE ARDHMËRIA I TAKON ISLAMIT 25
TË JEM MUSLIMAN NË FAMILJE DHE NË SHTËPINË TIME 27
T'I MBIZOTËROJ EMOCIONET E MIA 31

المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

Hamdi i qoftë All-llahut, Zotit të botëve. Salavatet dhe selamet tona i qofshin drejtuar

Pejgamberit të Tij të nderuar.

المؤسسة الإسلامية للشباب
Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Fillimisht bindshëm duhet të theksojmë, se kur Islami thellohet në zemër si besim, ithtarit të tij i jep fuqi të jashtëzakonshme të ngjeshur me hakun dhe hajrin që nuk lejojnë mospërfilljen. Përkatësia islame, nëse është vetëm fjalë e shkruar në letërnjoftim që vërtetoh se bartësi i tij është musliman, atëherë ajo është përkatësi e thatë të cilën e vërejmë te shumica e njerëzve. A thua kjo fjalë mjafton për vërtetimin e identitetit fetar ?!!

Mirëpo, kur njerëzit e jetojnë Islamin me respekt të plotë dhe realizim praktik, atëherë kjo është përkatësi e vërtetë që e kërkon All-llahu prej robërve të vet për të cilën Atij edhe iu dhanë besën. Islami është fe që natyra e saj e shëndoshë nuk pranon të qëndrojë e shkëputur nga jeta njerëzore në një kohë kur shkatërrimi po përhapet në tokë e në dete nga vetë duart e njerëzve. Bindja e atyre që e pasojnë këtë fe le të jetë serioze, sepse ajo është amanet dhe janë përgjegjës për të.

Këtë shkresë ua dedikojmë:

- Atyre që thjeshtë e bartin këtë emër ose kanë mangësi me kërkesat e Islamit, që t'u bëhet e qartë rruga që shpie drejt All-llahut të Lartësuar.

- Atyre që e kuptuan rrugën e vërtetë të Tij, por ende janë në qorrsokak, që t'i kthehen rrugës së All-llahut xhel-le shanuhu.

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
✉ islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

- Atyre që realisht e prezentojnë Islamin dhe jetojnë me të, që të ndjejnë përgjegjësinë e amanetit dhe të kërkojnë ndihmën e Fuqiplotit.

Lusim All-llahun e Madhëruar që me anë të kësaj shkrese të na udhëzojë neve dhe lexuesit në rrugën e shpëtimit.

المؤسسة الإسلامية للشباب
Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Ç'DO TË THOTË PËRKATËSIA IME ISLAME

Çështjet e trajtuara në këtë faqe të titulluar "Ç'do të thotë përkatësia ime islame" i prezentojnë karakteristikat më të rëndësishme të cilat duhet t'i posedojë njeriu për të qenë muslimani njëmendtë.

Përkatësia ndaj Islamit nuk është përkatësi që fitohet sipas trashëgimisë e as përkatësi e fituar me legjitimim. Ajo po ashtu s'është përkatësi të cilën duhet deklaruar me fizionominë e jashtme por, është përkatësi ndaj Islamit, duke u përqëndruar në Islam, duke u ambientuar në të dhe ate në të gjitha fushat e jetës.

Në vijim do ti theksojmë shkurtimisht vetitë më të dalluara të cilat doemos duhet të gjenden te muslimani për të qenë përkatësia e tij ndaj kësaj feje përkatësi e plotë dhe e sinqertë.

" Ai (Ibrahimi) edhe më parë, e edhe ky (Kur'ani) ju quajtën muslimanë, për të qenë i Dërguari dëshmitar juaji dhe për të qenë ju dëshmitarë ndaj njerëzve ".

(Haxhxh, 78).

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

Këto veti i kemi përkufizuar në tetë pikët dhe i kemi ndarë në tema, duke mos pretenduar se i kemi përfshirë të gjitha. Ato janë :

1) Të jem musliman në besimin tim.

2) Të jem musliman në ibadetin tim.

3) Të jem musliman në ahlakun tim.

4) Të jetoj vetëm për Islamin.

5) Të besoj se puna për Islamin është obligim.

6) Të besoj se ardhmëria i takon Islamit.

7) Të jem musliman në familje dhe në shtëpinë time.

8) T'i mbizotëroj emocionet e mia.

المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

TË JEM MUSLIMAN NË BESIMIN TIM

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

Besimi i drejtë është kushti themelor prej kushteve të përkatësisë në këtë fe. Muslimani duhet të besojë ashtu siç besuan të parët e mirë (selefus-salih) dhe dijetarët e fesë që është dëshmuar për ta, për të kuptuarit e drejtë ndaj fesë së All-llahut xh.sh. Nga kjo nënkuptohet se, që të jem musliman në besim, kërkohet:

1) Të besoj se Krijuesi i ekzistencës, është Zoti, I fuqishëm, I dijshëm, duke u vërtetuar nga shpikjet dhe renditjet e sakta që i vërejmë në ekzistencë. All-llahu thotë:"Sikur të kishte në to (në qiej e në tokë) zota të tjerë pos All-llahut, ato të dyja do të shkatërroheshin. Larg asaj që i përshkruajnë është All-llahu, Zoti i arshit", (Enbija, 22).

2) Të besoj se Krijuesi Lavdiplotë nuk e krijoi ekzistencën kot dhe pa qëllim, sepse nuk është e arsyeshme për Atë që përshkruhet me përsosuri të jetë i pa qëllim, të atë që e kot ji." A mendua se Ne ju krijuam kot dhe se nuk do të ktheheni te Ne" (Mu'minun, 115).

3) Të besoj se All-llahu i Lartësuar dërgoi Pejgamberë dhe i zbrit Librat e shenjtë për t'i njohur njerëzit me Zotin e tyre. Ndërsa prej pejgamberëve, i fundit ishte Muhammedi alejhis-selam."Ne dërguam në çdo popull Të dërguar që t'u thonë: "Adhuroni vetëm All-llahun, e largonu djajve (adhurimit të tyre)!" Por, pati nga ata që All-llahu i udhëzoi, dhe pati nga ata që ishin të gjykuar me humbje..." (Nahl, 36).

4) Të besoj se qëllimi i jetës është njohja e All-llahut të Madhëruar, respekti dhe adhurimi ndaj Tij."Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër, pos, që të Më adhurojnë. Unë nuk kërkoj prej tyre ndonjë furnizim e as s'dëshiroj që ata të më ushqejnë ", (Edh-dharijatë, 56,57).

5) Të besoj që shnërblimi i besimtarit është Xhenneti, e dënimi i jobesimtarit është zjarri."Një grup për në Xhennet, kurse një grup për në zjarr" (Esh-shura, 7).

6) Të besoj se njeriu e fiton të mirën dhe të keqen me zgjedhjen e tij, por nuk mund të vjen hari pa pëlqimin e All-llahut dhe ndihmën e Tij, ndërsa nuk mund të vijë sherri me imponimin nga Ai.

المؤسسة الإسلامية للشباب
Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth
Seebachersstrasse 67
CH-8052 Zürich
+ 41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

"Pra, ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten, ka dështuar ai që e poshtëroi vetveten" (Shems 9,10). "Ç'do njeri është peng i veprës së vet"(Muddeththir, 38).

7) Të besoj se legjislacioni i takon All-llahut dhe se dijetarët mund të hulumtojnë në ato sfera ku ka lejuar All-llahu. "Për çdo send që nuk pajtoheni, gjykimi për të është te Allahu. Ai (gjykatësi i famshëm) është All-llahu, Zoti im, vetëm Atij i jam mbështetur dhe vetëm Atij i drejtohem." (Shura, 10).

8) Ta njoh All-llahun Fuqiplotë nëpërmjet emrave të tij të ndritur dhe cilësive të Tij. Nga Ebu-Hurejre përcillet se I Dërguari, i All-llahut, paqja dhe shpëtimi qofshin mbi të, ka thënë "All-llahu ka 99 emra, pa një, njëqind. Çdo njeri që i ka nxënë përmendësh do të hyjë në Xhennet. Ai është tek dhe e don tekun". (Buhariu dhe Muslim).

9) Të meditoj në krijesat e All-llahut e jo për qenësinë e Tij. Alejhiselami tha:"Meditoni në krijesat e All-llahut e mos meditoni në All-llahun, sepse ju nuk mund ta përshkruani madhësinë e Tij",(Transmetuan Ebu Neimi në "El-Hulijjeh" dhe Asbahani në " Et-Tergib vet-Terhib").

10) Ndërsa për cilësitë e Allahut të Madhërishëm na bëjnë me dije shumë ajete kur'anore, si për cilësinë e përhershmërisë dhe të pafundësisë, ashtu edhe se All-llahu nuk është i njëjtë me krijesat që i krijoi, nuk ka fëmijë e as prindër dhe asgjë Atij nuk i ngjason. Po ashtu ekzistojnë ajete që theksojnë fuqinë e Tij, gjerësinë e diturisë së Tij, lirinë e vullnetit dhe dëshirës së Tij.

11) Të besoj se mendimet e selefit (gjeneratës së parë të muslimanëve, është më e dobishme të pasohen se sa të komentohen, ose të alegorizohen apo hulumtohen këto cilësi të All-llahut të Lartësuar. Ndërsa, thellimi i gjatë në këto sfera është i pafrytshëm.

Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth
Seebachersstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

12) Ta adhuroj vetëm All-llahun dhe mos ta rivalizoj me Të askënd."Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t'u thonë: "Adhuroni vetëm All-llahun, e largonu djajve (adhurimit të tyre)". (Nahl, 36).

13) Ti frikësohem vetëm Atij, një frikë që do të më largonte nga të gjitha ndalesat (haramet). "Ata, që pa e parë i frikësohen Zotit të vet, për ta ka falje dhe shpërblim të madh". (Mulk, 12).

14) Ta përmend Lavdiplotin vazhdimisht, sepse të përkujtuarit (zikri) është ilaç me efikas për shpirtin, përballë rrjedhave të kohës. Është e vërtetë fjala e All-llahut kur thotë:"Ata që besuan dhe me të përmendur All-llahun, zemrat e tyre qetësohen". (Er rra'd, 28). "Mesh i ri byllë ajtë para këshillave të Zotit, atij ia shoqërojmë një djall që nuk i ndahet kurrë. E ata (djajtë) do t'i shmangin nga rruga e drejtë, kurse (jobesimtarët) mendojnë se janë duke i udhëzuar". (Zuhruf, 36,37).

15) Ta dua All-llahun xh.sh., një dashuri që më bën të lidhur me Të, ashtu që të më shtyjë të jem më i mirë, më flijues dhe më luftëtar në rrugën e All-llahut xhel-le shanuhu (xhihad fisebilil-lah) ku nuk do të më pengojnë as të mirat e përkohshme të kësaj bote e as lidhjet farefisnore."Thuaj (o I Dërguar): "Në qoftë se etërit tuaj, djemtë tuaj, vëllezërit tuaj, bashkëshortet tuaja, farefisi juaj, pasuria që e fituat, tregtia që frikoheni se do të dështojë, vendbanimet me të cilat jeni të kënaqur, (të gjitha këto) janë më të dashura për ju se All-llahu, se I Dërguari e Tij dhe se lufta për në rrugën e Tij, atëherë pritni derisa All-llahu të sjell vendimin e tij. All-llahu nuk vë në rrugën e drejtë njerëzit e prishur". (Tevbe, 24).

Të jem lakmues në ëmbëlsinë e imanit (besimit).Muhammedi alejhisselam ka thënë: "Ai te i cili gjenden tri gjëra e ka shijuar ëmbëlsinë e imanit: Ta dojë All-llahun dhe Të Dërguarin e Tij më

المؤسسة الإسلامية للشباب
Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth
Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

shumë se çdo gjë tjetër; Ta dojë njeriun vetëm për hir të Allahut (pa kurrfarë interesi tjetër); Ta urrejë kthimin në kufër (mosbesim) sikur që urren të hidhet në zjarr". (Buhariu).

16) Të mbështetëm në All-llahun në çdo situatë."Kush i mbështetet All-llahut, Ai i mjafton atij" (Talak, 3). Ndërsa, porosia më e urtë e Pejgamberit alejhis-selam është: "Ruaje All-llahun, të ruan Ai ty; ruaje All-llahun do ta gjesh gjithmonë me ty; kur të lutesh, lute All-llahun; kur të kërkosh ndihmë, kërko prej All-llahut; dije se në qoftë se edhe i gjithë populli bashkohet që të të ndihmuar nuk mund të të ndihmojë përveç asaj çfarë të është shkruar prej All-llahut. Por edhe nëse i gjithë populli bashkohet që të të dëmtojë nuk mund të të dëmtojë me asgjë, përveç asaj që të është shkruar prej All-llahut. Janë ngritur lapsat dhe janë mbyllur fletoret". (Tirmidhiu).

17) Ta falënderoj All-llahun për mirësitë dhe begatitë e Tij, sepse falënderimi është detyrë e çdo robi ndaj Sunduesit:"All-llahu ju nxori nga barqet e nënave tuaja (si foshnja) që nuk dinit asgjë. Ju pajisi me (shqisa për) të dëgjuar, me të parë dhe me zemër, ashtu që të jeni falënderues"(Nahl, 78). Ndërsa All-llahu për falënderuesit premton shtimin e begative, ndërsa për refuzuesit lajmëron shtimin e humbjeve."Dhe (përkujtoni) kur Zoti juaj njoftoi bindshëm: Nëse falënderoni do T'ua shtoj të mirat, e nëse e përbuzni, s'ka dyshim, dënimi Im është i vështirë". (Ibrahim, 7).

18) T'i kërkoj falje All-llahut sepse kërkimi i faljes i shlyn mëkatet dhe i përtërinë pendimet."Kush e bën ndonjë të keqe ose e ngarkon veten e pastaj kërkon falje tek All-llahu, ai e gjen All-llahun falës dhe mëshirues". (Nisaë, 110)."Edhe ata të cilët kur bëjnë ndonjë (mëkat) të shëmtuar ose i bëjnë zullum vetvetes, e përmendin All-llahun dhe kërkojnë falje për mëkatet e tyre, e kush i tal mëkatet përveç All-llahut. Dhe që duke e ditur, nuk vazhdojnë në atë që e kanë punuar (në të keqen). Shpërblimi i të tillëve është falja nga Zoti i tyre..." (Ali Imran, 135,136).

المؤسسة الإسلامية للشباب
Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth
Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
+ 41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

19) Ta përkujtoj All-llahun kur jam vetë, por edhe në shoqëri, duke e pasur parasysh fjalën e Të Madhërishmit "Nuk bëhet bisedë e fshehtë mes tre vetave e të mos jetë Ai i Katërti; e as mes pesë vetave e Ai të mos jetë i gjashti..." (Muxhadele, 7).

المؤسسة الإسلامية للشباب
Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth



TË JEM MUSLIMAN NË IBADETIN TIM

Ibadeti (adhurimi) është nënshtrimi final dhe nëjenja e plotë ndaj madhërisë së Pavdiplotë. Logjika islame ka për qëllim që jeta jonë të jetë adhurim dhe respekt, duke e realizuar fjalën e All-llahut xhel-le shanuhu:"Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër, pos që të Më adhurojnë. Unë nuk kërkoj prej tyre ndonjë furnizim e as s'dëshiroj që ata të më ushqejnë" (Dharijatë, 56,57), dhe fjalën e Tij:"Namazi im, kurbani im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për All-llahun, Zotin e botëve !" (En'am, 162).

Me qëllim që të jem musliman në ibadetin tim obligohem:

- Ibadeti im të jetë i gjallë dhe i lidhur ngushtë me Krijuesin, e kjo është shkalla më e lartë e mirësisë në ibadet. Ja si e ka përshkruar I Dërguari i All-llahut, paqja dhe shpëtimi qofshin mbi të: "Adhuroje All-llahun sikur po e sheh, e ti edhe nëse nuk e sheh, Ai të sheh ty". (Buhariu dhe Muslimi).

Seebachersstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

- Në ibadetin tim të jem me zemër të zgjuar, i izoluar nga bota e dukshme. Në këtë tërheq vërejtjen Pejgamberi alejhisselam kur thotë:"Nuk ka vlerë namazi i robit përveç aty ku e ka pasur në mend". Musned Firdeusi.

- Ibadeti im të jetë me përqëndrim dhe frikë. Thotë Aisheja, kënaqësia e All-llahut qoftë mbi të:"Resulull-llahu alejhisselam na fliste dhe i flisnim, por kur vinte koha e namazit, dukej sikur të mos na njihte dhe mos ta njihnim".(Koleksionoi Ezedin).

- Të jem ndaj ibadetit tim lakmues derisa t'i afrohem All-llahut me namaz nafile (jashta farzeve) ashtu që t'i përgjigjem fjalës së All-llahut në hadithin kudsij:"I dashi Jilet armiqësisht ndaj robit tim, atij do t'i shpalli luftë. Nuk mund të afrohet robi im ndaj Meje me asgjë që unë e dua se sa me atë që Unë ia kam obliguar.E kur më shumë vazhdon robi im të afrohet ndaj Meje me nafile, atëherë filloj ta dua. E kur e dua, bëhem veshi i tij me të cilin dëgjon, syri i tij me të cilin sheh, dora e tij me të cilën lufton dhe këmba e tij me të cilën ec, e nëse më lutet i përgjigjem, nëse kërkon strehim e strehoj. Nuk Më vjen keq për asnjë gjë kur Unë e punoj sesa kur shpirti i një besimtari e urren vdekjen, derisa Unë urrej t'i sjell kobin". (Muslimi).

- T'i kushtoj kujdes faljes së namazit të natës, sepse e vërtetë është fjala e All-llahut kur thotë:"E s'ka dyshim se aktiviteti i natës është fuqizues dhe fjalë më e qartë". (Muzzemmil, 6). All-llahu i Lartësuar i përshkruajti besimtarët me fjalën e Tij:"Ishin ata të cilët pak fiinin natën. Dhe në syfyr (kah mbarimi i natës), ata kërkonin falje për mëkatet".(Edh-dharijatë,17, 18).

"I ngrenë trupat e tyre prej dyshekëve, duke e lutur Zotin e tyre nga frika dhe nga shpresa dhe nga ajo që Ne u kemi dhënë (pasuri) atyre, ata japin". (Es-sexhde, 16).

المؤسسة الإسلامية للشباب
Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth
Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ +41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

- T'i lexoj dhe hulumtoj ajetet kur'anore posaçërisht në mëngjes:"Vërtet, Kur'ani i mëngjesit është dëshmi". (Isra, 78). Ta lexoj atë me frikë dhe përvuajtje se Muhammedi alejhisselam ka thënë:"Ky Kur'an është zbritur me përvuajtje, e kur ta lexoni atë, lexoni me përvuajtje" (Ebu Ja'li dhe Ebu Neim në "Hulijje"). Gjithashtu është detyrë imja ta kujtoi fjalën e Allllahut:"Sikur Ne ta zbritnim këtë Kur'an mbi ndonjë kodër, do ta shihje atë të strukur dhe të çarë prej frikës nga All-llahu" (Hashr 21). Pastaj, fjalën e Pejgamberit alejhisselam:"Ka lexues të Kur'anit që vetë Kur'ani i mallkon" dhe fjalën: "Zemra që nuk ka në vete Kur'an është zemër e prishur". Po ashtu Pejgamberi alejhisselam ka thënë:"Ky Kur'an është litar i fortë i Allllahut; dritë e hapët dhe shëruesi më i dobishëm; mbrojtje për atë që është kapur fort të dhe shpëtim për atë që e ndjek, nuk i fiket drita e pastaj të nënçmohet, nuk flen e pastaj të zgjohet, nuk ndalen mrekullitë e tij, nuk është i mërzitshëm edhe pse shpesh përsëritet. Këndohe se All-llahu ju shpërbleft gjatë këndimit për çdo shkronjë nga dhjetë të mira. Nuk ju them se eli-lam-mim llogaritet një shkronjë, por elifi shkronjë, lami shkronjë dhe mimi shkronjë"(Transmetoi Hakimi). Ndërsa Ebu Dherre, na porosit:"Kendoje Kur'anin, sepse ai do të jetë dritë ytja në tokë e thesari yt në qiell". (Transmetoi Ibni Hibbani)

Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

TË JEM MUSLIMAN NË AHLAKUN TIM

Nuk ka vlerë besimi pa sjellje dhe moral. Muhammedi alejhisselam ka thënë:"Besimtari më i përkryer me imanin është ai, ahlaku i të cilit është më i mirë". Gjithashtu:"Nuk ka imanin besimi ai

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
+41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

që imanin e tij e mbështet në shpresa, por ai të cilit imani i është mbjellë në zemër dhe e vërteton me vepër". (Dejlemi në Musnedin e tij).

Pa sjellje fisnike ibadetet mbeten lëvizje pa kurrfarë vlere. Është cekur fjala e All-llahut rreth namazit:"...Vërtet namazi largon nga të shëmtuarat dhe të intuarat..." (Ankebut, 45). Kurse, Pejgamberi alejhisselam thotë:"Ai të cilin namazi i tij nuk e largon nga fjalët e shëmtuara dhe punët e mbrapshta nga All-llahu nuk fiton asgjë por largimi." (Transmetoi Taberanius). Ndërsa rreth agjërimit thotë:" Kur të agjëroni mos shani e mos bërtitni, e në qoftë se dikë prej jush e shan ndonjëri apo i vërsulet me fjalë le t'i thotë "unë jam agjërues" (Tirmidhiu). E rreth haxhxhit All-llahu i Madhëruar thotë:"Haxhxhi është në muaj të caktuar, e kush e bën (fillon ta zbatojë) haxhxhin në këte muaj, nuk duhet t'i afrohet gruas, nuk bën të mëkëmitë dispozitu e Shen atit e as nuk duhet të shkaktojë grindje..." (Bekare, 197).

Cilësitë e muslimanit

- Të ruajturit nga dyshimet. Me argument nga fjala e Të Dërguarit alejhisselam:"Vërtet, e lejuara (hallall) është e qartë, por edhe e ndaluara (haram) është e qartë. Ndërmjet tyre janë gjërat e dyshimta, të cilat shumë njerëz nuk i dinë. Kush mbrohet nga gjërat e dyshimta është siguruar në pikëpamje të besimit dhe të nderit, ndërsa kush bie në gjëra të dyshimta, ka rënë në të ndaluarën (haramin), ngjashëm si bariu, i cili e ruan kopenë rreth vendit (kullosës) së ndaluar, për një çast kopeja mund t'i ikë dhe të kullosë në vend të ndaluar. Çdo sundues i ka kufijtë e vet, kurse kufijtë e All-llahut janë ndalesat (haramet) e Tij. A nuk ekziston në trup një organ i cili kur është i shëndoshë i shëndoshë është i tërë trupi, ndërsa kur prishet, prishet i tërë trupi. E kjo është zemra !" (Buhariu dhe Muslimi).

المؤسسة الإسلامية للشباب
Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth
Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

- Ulja e shikimit. Përderisa shikimi është ngjallës i epshit, Kur'ani i shenjtë na ka porositur t'i ulim shikimet. Prandaj I Lartmadhërishmi në Kur'an tha:"Thuaju besimtarëve t'i ndalin shikimet (prej haramit)..." (Nur, 30) "Thuaju edhe besimtareve t'i ndalin shikimet e tyre..." (Nur, 31).

- Ruajtja e gjuhës. Ta ruaj gjuhën nga sharjet, fjalët e kota, përgojimet dhe llafosjet e tepërta. Thotë Imam Nevéviu:"Dije se obligohet çdo mukel-lef (i moshuar) ta ruajë gjuhën e tij nga çdo fjalë, përveç fjalëve për të cilat paraqitet nevoja për të thënë. Andaj kur dëshiron me folurit, është e rrugës (sunnet) të ndërpriten fjalët.

- Cilësia e turpit. Të jem i turpshëm në çdo rast, por në rast se duhet të flasë për të vërtetën ajo duhet të shprehet me guxim. Nga vetitë e turpit janë: të mos ndërhyj në çështjet e të tjerëve, pastërtia e shikimit, pastërtia e gjuhës dhe ulja e zërit. Nga Muhammedi alejhisselam përcillet se ai ka qenë më i turpshëm se virgjëresha në gjerdekun e martesës. Ai thoshte: "Imani është shtatëdhjetë e sa degë, më e vlefshmja është fjala LA ILAHE IL-LALL-LLAH (nuk ka zot tjetër përveç All-llahut) ndërsa e fundit është largimi i ndonjë pengese nga rruga. Edhe turpi është pjesë e imanit."(Buhariu dhe Muslimi).

- Fjala e drejtë. Muslimani duhet të jetë i drejtë në fjalë të mos gënjejë, të them të vërtetën e të mos ketë frikë nga qortimet e ndokujt. Gënjeshtra është dera e shumë rrugëve djallëzore, ndërsa mbrojtja nga të kaqijat e gënjeshtrës, duke i mbizotëruar emocionet e saj, njeriu ruhet edhe nga vesveset e shejtanit. Gënjeshtra e shkatërron shpirtin dhe ia humb dinjitetin njeriut. Pejgamberi alejhisselam thotë: "Fjala e drejtë çon tek e bukura, kurse e bukura çon në Xhenet, e njeriu flet drejt (derisa ajo të bëhet shprehi), atëherë tek All-llahu shkruhet i drejtë. Gënjeshtra çon

Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth
Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
+ 41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

në krim, e krimi çon në Xhehennem, e kur njeriu gënjenë (derisa ajo i bëhet shprehi), atëherë tek All-llahu shkruhet gënjeshtar". (Buhariu dhe Muslimi).

- Durimi. Të jem durimtar duke qenë i vetëdijshëm për shpërblimin e All-llahut. Durimi është nyja kryesore e besimit. Durimtarët do t'i përjetojnë shpërblimet e tyre pa llogari, sepse ata i përballojnë të gjitha fatkeqësitë me nënshtrim të plotë dhe kënaqësi ndaj caktimit të All-llahut. A mund të jetë njeriu i nevojshëm për diç më shumë sesa për durim të mirë të këtë botë që është përplot trazira. Në Kur'an thuhet:"Ne do t'ju sprovojmë me ndonjë frikë, me uri, me ndonjë humbje nga pasuria, nga jeta e edhe nga frytet, por ti jenju mizhde surimarëve" (Bekare, 155). Ndërsa Alejhisselami ka thënë: " S'ka gëlltitje më të dashur tek All-llahu nga ajo kur robi e gëlltit hidhërimin vetëm për All-llahun, e All-llahu me këtë ja mbush zemrën me imas."

- Modestia. Të jetë modest me vëllezërit e mi, të mos bëj dallim ndërmjet të varfërit dhe të pasurit, sepse Pejgamberi alejhisselam ka kërkuar mbrojtje tek All-llahu ta ruajë prej mendjemadhësisë dhe ka thënë: "Nuk hyn në Xhennet ai i cili ka në zemrën e tij një grimë mendjemadhësie".(Muslimi).

- Largimi nga keqkujtimi dhe përcjellja e avretit të muslimanëve. Këtë më së miri e ilustron fjala e All-llahut:"O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat dhe mos hulumtoni zbulimin e të metave të njëri-tjetrit, dhe mos përgojoni njëri - tjetrin; a mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Atë pra e urreni! Kini frikë nga ndëshkimi i All-llahut, e All-llahu është mëshirues, Ai e pranon shumë pendimin". (Huxhuratë, 12).

المؤسسة الإسلامية للشباب
Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth
Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

- Bujaria dhe fisnikëria. Të jem bujar dhe fisnik, të japë shpirtin e mallin për All-llahun ashtu që ta vërtetoj moskoprracinë e shpirtit, duke shpenzuar çdo dirhem e dinar. Sa nga pozitat dhe rastet e volitshme dështuan dhe nuk u shfrytëzuan nga mungesa e bazës materiale. Ndërsa në Kur'an kemi dhjetëra ajete ku paralelisht janë theksuar cilësitë e imanit me cilësitë e bujarisë:"Dhe prej asaj që Ne u kemi dhënë, ata japin (zeqate, sadaka, etj)."(Bekare, 3). Le ta dëgjojnë koprracët fjalën e Të Dërguarit alejhisselam:"Çdo mëngjez kur njeriu zgjohet, nga gjumi dy melaqe zbresin dhe pranë tij luten. Njëra lutet:"O Zot, nëse është prej bujarëve, shtoja pasurinë." Tjetra lutet:"O Zot nëse është prej koprracëve, humbja pasurinë."(Buhariu dhe Muslimi).

Atëherë pra prej nesh kërkohet që të jemi shembull të mirë ndërmjet njerëzve dhe zbatues të vërtetë të parimeve dhe edukatës islame si në të ngrënë dhe në të pirë ashtu edse në te folur në të përshëndetur, në rrugë e në shtëpi dhe në çdo lëvizje apo veprim.

TË JETOJ VETËM PËR ISLAMIN

Mbështetja ime në Islam më obligon të jetoj me besim, adhurim dhe me moral. Ta jetoj në vete, në shtëpi dhe në familje, ta aktivizoj tërë jetën time për të, të veproj për ngritjen e çështjes, dhe forcimin e pushtetit të tij.

Njerëzit sipas botëkuptimeve të jetës në këtë botë, ndahen në tre grupe:

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

- Një grup jeton vetëm për këtë botë. Në të bëjnë pjesë materialistët në teori apo në praktikë. Kur'ani i shenjtë i quajti dehrijtunë (natyralistë):"Nuk ka tjetër, pos jetës sonë të kësaj bote, lindemi, vdesim dhe nuk do të ngjallemi !". (Mu'minunë, 37). Komunistët (të cilët tani më veç janë tretur), laikët, ekzistencialistët, të gjithë frymëzohen nga e njëjta teori.Lenini thoshte:"Botën nuk e krijoi kurrfarë zoti apo njeriu, ka qenë, është dhe do të jetë përherë zjarr aktiv, ndezët dhe fiket në pajtim me ligje të caktuara".

Kur njeriu e injoron jetën përtej varrit, atëherë ai të vetmin preokupim e ka këtë botë dhe të arriturat e tij do të kufizohen vetëm në suazat e kësaj (materie).

- Një grup janë të humbur midis dy kaheve. Besimi i tyre është cregulluar ndërsa angazhimi i tyre në këtë botë është i koti. Ata edhe pse besojnë në All-llahun dhe në Ditën e Ringjalljes, besimi i tyre është sipërfaqësor, i ndarë plotësisht nga realiteti praktik.

- Njerëzit që i takojnë grupit të tretë e konsiderojn dynjanë arë të ahiretit. Ata janë besimtarë të vërtetë, kuptuesit e realitetit të jetës. Vlera e kësaj bote në krahasim me ahiretin për ta është e tillë siç e përshkruan All-llahu i Madhërishëm:"Jeta e kësaj bote s'është gjë tjetër vetëmse një përjetim e mashtrim. S'ka dyshim se bota tjetër është më e dobishme për ata që ruhen.A nuk logjikoni ?"(El En'am, 32).

Këtë e vërteton edhe fakti se të gjitha sukseset njerëzore nga të arriturat shkëncore nuk kanë për qëllim tjetër pos plotësimin e kënaqësive trupore të njeriut, e jo edhe rregullimin dhe ndërtimin e kësaj hapësire në paqe e siguri. Islami nuk ndalon zbulimet dhe hulumtimet shkëncore, por me shqetësim i cila nuk i jep dëm njeriut pastaj në mënyrë që të shpëtohen ato mira dhe të dominojë harmonia në shoqërinë njerëzore.

Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth
Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ +41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

Si të jetoj për Islamin

Që t'ia kthej jetën Islamit obligohem t'i kuptoj disa gjëra dhe t'ju përmbahem atyre:

1. Ta kuptoj qëllimin e kësaj jete:"Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër, pos që të më adhurojnë "(Edh - dharijatë, 56).

2. Ta njoh vlerën e dunjasë në krahasim me ahiretin: "Përjetimi i kësaj bote është i paktë, e përnatë që është i devotshëm, bota tjetër është shumë më e dobishme..."(En-nisa, 77).

Thuhet se Pejgamberi alejhisselam qëndroi një d të para një grimbull të plehut, i thirri shokët e vet duke ju thënë: "Ejani ta shihni dynjanë". Pastaj mori një leckë të grisur dhe një asht të kalbur dhe shtoi:"Ja kjo është dynjaja".

3. Të jem i vetëdijshëm se nga vdekja nuk ka ikje."Çdo gjë që është në të (në tokë) do të zhduket. E do të mbetet vetëm Zoti yt që është i madhëruar dhe i nderuar". (Rrahman, 26,27)."Ç'do njeri do ta shijojë vdekjen, e shpërblimet tuaja do t'ju plotësohen Ditën e kijametit. Kush i shmanget zjarrit dhe futet në Xhennet, ai ka arritur shpëtim, e jeta e kësaj bote nuk është tjetër pos një përjetimi mashtrues". (Ali Imran, 185). Nga Pejgamberi alejhisselam përcillet:"Përkujtoni humbësin e kënaqësive dhe ndarësin e shoqërive" (Tirmidhiu). Nga Ebu Hurejre radijall-llahu anhu thuhet: Prezentonin me Resulull-llahun salall-llahu alejhi ve selvem, në varrimin e një të vdekuri. Ai u ul pranë një varreze dhe tha:"Çdo varr do t'i vijë dita kur do të thirret me zë të qartë dhe të dëgjueshëm: O biri i Ademit, a më harrove? A nuk e ditë se unë jam shtëpi e vetmisë, shtëpi e mërgimit, shtëpi e mërzitshme, shtëpi e krimbit, dhe shtëpi e ngushtë përveç atij që All-

Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth
Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
+ 41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

llahu i mëshirshëm do t'ia zgjerojë. Pastaj shtoi:"Varri ose është kopsht prej kopshteve të Xhennetit ose gropë prej gropave të zjarrit (Xhehennemit)".(Taberaniu)

4. Ta njoh realitetin e Islamit, duke i njohur bazat dhe dispozitat e tij, atë që është e lejuar dhe atë që është e ndaluar. Dhe thuaj "Zoti im, ma shto diturinë" (Taha, 114).

Ndërsa Pejgamberi alejhisselam ka thënë:"Dijetarët janë trashëgimtarët e Pejgamberëve".

5. Ta njoh realitetin e xhahilijjetit (jetës joislame), duke i studiuar ideologjitë, drejtimet dhe traditat e saj. E vërtetë është fjala e Muhammedit alejhisselam kur thotë: "Kush ngjason me ndonjë popull, është i siguruar nga kurthet e tyre".

Cilësitë e atyre që jetojnë për Islamin

Që të jetoj për Islamin, doemos duhet të përshkruhet jeta ime me disa veti me të cilat do të dallohet nga jeta e njerëzve të tjerë: - Të përqëndrohem praktikisht në Islam, sepse imani nuk përjetohet me shpresa por ngulitet në zemër dhe dëshmohet në vepër. "Ata janë të cilët besuan dhe bënë vepra të mira, ata janë të lumtur dhe kanë ardhmëri të mirë".(Rra'd, 29). "A po i urdhëroni (thirrni) njerëzit për punë të mira, e veten tuaj po e harroni? Ndërsa ju e lexoni librin (Teuratin). A nuk po mendoni?" (Bekare, 44).

- Të përkufizohem vetëm në interes të Islamit, sepse Alejhisselami ka thënë: "Shihni rreth boshtit të Kur'anit, asnjëri si fillet" (Hakimi)Po ashtu ka thënë:"Ju jeni në një kopsht (livadh) prej kopshteve islame mos lejoni që askush t'ua marr atë".

المؤسسة الإسلامية للشباب
Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth
Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
✉ islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

3. Të jem krenar me hakun dhe i bindur në All-llahun. Kjo është cilësi e besimtarëve."E tërë krenaria i takon All-llahut, Të Dërguarit të Tij dhe besimtarëve". (Munafikun, 8). "E mos u dobësoni (fizikisht) dhe mos u dëshpëroni (shpirtërisht) derisa ju jeni më të lartit, po qe se jeni besimtarë të sinqertë".(Ali imran, 139). Thuhet se kur muhaxhirët, të cilët u strehuan në Abisini për mbrojtjen e fesë së tyre, hynë te Nexhashiu, priftërinjtë dhe murgjit u urdhëruan atyre t'i përkulen mbretit, kurse Xha'fer bin Ebi Talibi, kënaqësia e All-llahut qoftë mbi të, me guxim ua ktheu:"Ne jemi popull që nuk i përkulet askujt tjetër pos All-llahut".

4. Puna ime të përcaktohet vetëm për Islamin, sepse mbështetja ime në Islam më obligon të punoj për të. Pastaj puna ime të jetë vetëm brenda shoqërisë islame që të ndihmohem me të tjerët për thirrjen në rrugë të All-llahut; udhëzim në të mira e mahnë nga e keqja, sigrisjen e individit musliman, shtëpisë muslimane dhe shtetit musliman. E vërtetë është fjala e All-llahut të Lartësuar kur thotë:"Ne do ta forcojmë ty krahun me vëllain tënd..." (Kasas, 35)."Ndihmohuni mes vete me të mira dhe me të mbara, e mosni me mëkate e me armiqësi" (Maide, 2). Gjithashtu fjalët e Pejgamberit alejhis-selam:"Muslimani për muslimanin është si kulla e fortifikuar ku çdo tullë e forcon tjetrën"; "Dora e All-llahut është me xhematin (bashkësinë);" Ujku e han atë që është i veçuar nga kopeja","Bëhu me xhematin islam dhe udhëheqësin e tyre".

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

TË BESOJ SE PUNA PËR ISLAMIN ËSHTË OBLIGIM



Puna për Islamin nuk kryhet vetëm përmes individit i cili e prezenton me besim dhe sjellje dhe shoqërisë e cila e përqafon Islamin me mendim dhe edukatë. Por, puna për Islamin është detyrë islame-juridike, nuk plotësohet derisa të formohet pushteti, i cili e merr përsipër këtë përgjegjësi dhe i mbron të drejtat e muslimanëve.

Meqë ky pushtet nuk ekziston, atëherë çdo neglizjencë dhe pakujdesi e muslimanëve trajtohet mëkat, e ky mëkat nuk falet derisa ta ndjejmë si përgjegjësi personale.

Se angazhimi për Islam është obligim dhe se për të kemi përgjegjësi na e bënë të qartë edhe të qenurit e tij obligimin argumentuar nga disa pikëpamje:

Në pikëpamje parimore

Puna për Islam është obligim, sepse është bazë që All-llahu i ngarkoi njerëzit me të:"O ti I Dërguar! Komunikoje atë që t'u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk e bën (kumtimin në tërësi) atëherë nuk e ke kryer detyrën (revelatën-risalën)" (Maide, 67)."Ata të cilët i fshehin argumentet dhe faktet që Ne i shpallëm, e pasi që ato ua sqaruan njerëzve në librin, të tillët i mallkon All-llahu, i mallkojnë edhe ata që mallkojnë" (Bekare, 159). Ndërsa, Resulull-llahu sallallahu alejhi ve sel-lem thotë:"Kush sheh prej jush ndonjë gjë të dëmshme (munker, të urrejtur), le ta ëmmbysë me dorën e vet, e nëse nuk ka mundësi, me gjuhën e vet, e nëse nuk ka mundësi me zemrën e vet, por kjo është shkalla më e ulët e besimit".(Tirmidhiu).

Në pikëpamje juridike

Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth
Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
+ 41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

Moszbatimi i Ligjit të All-llahut (Sistemit islam) në sipërfaqe të tokës dhe ardhja e sistemeve njerëzore në pushtet, i obligon muslimanët të veprojnë për përtërirjen e jetës islame dhe njerëzit t'i nënshtrohen vetëm All-llahut në çdo pore të jetës së tyre.

"Për Zotin tënd jo, ata nuk janë besimtarë (të asaj që të zbriti ty, as të asaj para teje) derisa të të mos zgjedhin ty për të gjykuar në atë konflikt ndërmjet tyre, e pastaj (pas gjykimit tënd) të mos ndjejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) të mos bindet sinceriht". (Nisë: 65). Në qofta se realizimi i shoqërisë islame dhe qeverisja me Ligjin e All-llahut xh.sh. është obligim i çdo personi, atëherë veprimi për përtërirjen e tij është obligim në pikëpamje jeridike me argumente nga rregullat e Sheriatit (Ligjit islam). "Ajo që nuk plotësohet vetëm me vaxhib (shkallë obliguese), ajo është vaxhib". Sot vendet islame po qeverisen me ligje romake, greke, franceze me sistemë ekonomike si ato kapitaliste apo socialiste, ndërsa angazhimi për flakjen e këtyre ligjeve dhe sistemeve është obligim i pakontestueshëm (farzi ajn) për çdo musliman, derisa udhëheqja t'i kthehet Islamit.

Në pikëpamje të patjetërsueshmërisë

Puna për Islamin është obligim i patjetërsueshëm për t'iu kundërvënë të gjitha rrymave bashkëkohore dhe kurtheve të armiqve të Islamit, për t'i ndalur të gjitha valët materialiste dhe ushtritë ateiste, të cilat i hercenohen Islamit vazhdimisht.

Vetëm nëse i bëimë një vlerësim analitik gjendjes të cilën po e përjetojnë vendet e Botës islame na bëhet e qartë se krijimi i një Fronti islam është obligim, bile duhet kuptuar si detyrë fetare, ku nuk guxojmë të pushojm apo të jemi pasivë në atë drejtim.

المؤسسة الإسلامية للشباب
Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth
Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
+ 41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

Prej vendeve islame ka të atilla që ankohen nga sundimi i pakicave nacionaliste dhe urrejtëse. Disa vende të tjera ankohen nga sundimi i partive majtiste apo djathtiste. Aq më tepër, sot vendet islame në përgjithësi po përjetojnë një situatë të mjerë dhe shkatërrimtare, po përjetojnë katastrofë në moral dhe sjellje, mendim dhe besim.

Në pikëpamje personale dhe shoqërore

Përgjegjësia e punës për Islamin konsiderohet përgjegjësi personale. Për rrjedhojë, rregulli i të gjitha obligimeve fetare për të cilat pasojnë shpërblimi apo dënimi."Çdo njeri është peng i veprës së vet" (Muddeth-thir, 38). Islami ashtu siç i bashkon njerëzit në mënyrë punëtore e përbashkët, që është ndërtimi apo rindërtimi, njëkohësisht çdo individ e bën përgjegjës për sferën e veprimit të vet brenda mundësive të tij, derisa ai është i vetëdijshëm dhe i arrit. Pra, derisa puna për Islamin është obligim personal në këtë sferë, ai është obligim shoqëror sa i përket përgjegjësisë për realizimin e veprimit. Një gjë të këtillë e argumentojnë rastet dhe shkaqet për të cilat nuk ka nevojë shumë të diskutohet. Prej tyre:

- Domosdoshmëria e punës për Islam është më e madhe se sa që e kujton vetë njeriu. Puna për Islam ka për qëllim çrrënjosjen e devijimeve të ndryshme dhe mosbesimit, dhe vendosjen e Islamit në vend të tyre. E gjithë kjo kërkon përpjekje të mëdha që njeriu vetë nuk mund t'i zbatojë, bile edhe nëse përpiqet dhe ju rri ballë për ballë me duhmën pengesave, por vetëm kësi formohet një lëvizje e organizuar dhe e përgatitur me vetëdije të lartë, aftësi dhe aktivitet.

- Puna e Pejgamberit alejhisselam kundër xhahilijjetit për krijimin e një, shoqërie islame dhe vazhdimi e jetës islame është argumenti bulmor se angazhimi i shfaratit është punë për Islam është obligim. Kështu flasin ngjarjet e jetës pejgamberike në të gjitha etapat.

المؤسسة الإسلامية للشباب
Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth
Seebahnstrasse 67
CH-8052 Zürich
+41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

- Rruga e veprimit islam është e shtruar me ferra, e përcjellur me sprova. Provokimet të cilat qëndrojnë në këtë rrugë janë të mëdha, kurse forcat të cilat e pengojnë Islamin janë të shumta. Prandaj, është më se i domosdoshëm ekzistimi i një lëvizjeje të organizuar që do të kishte program të gjerë dhe anëtarë të mjaftueshëm për t'u bërë ballë të gjitha provokimeve dhe pengesave.



المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondacioni i Rinisë Islame

Stiftung der Islamischen Jugend

Foundation of Islamic Youth

TË BESOJ SE ARDHMËRIA I TAKON ISLAMIT

Ardhmëria është e Islamit, sepse është prej All-llahut dhe se (ajo që) është e atilë për ta tërhequr qeriin njerëzore. Ky është sistem i vetëm, i përshtatshëm për nevojat e natyrës njerëzore."A nuk e di Ai që ka krijuar, kur dihet se Ai depërton në thellësi të sekreteve, i njeh hollësitë"(Mulk,4).

- Hyjnizimi i këtij sistemi është ai që e mbivlerëson kundrejt të gjitha sistemeve tokësore dhe veçohet me cilësinë e përhershmërisë dhe të përshtatshmërisë për çdo kohë dhe për çdo vend.

- Universaliteti i këtij sistemi mëshirohet me ngjyrën njerëzore...Me ngjyrën e cila bën t'i kapërcejë të gjitha traitat lokaliste, raciste, kombëtare, fisnore, tradicionale...Me ngjyrë ku universaliteti i saj ka bazë ngjyrën hyjnore.

- Elasticiteti i këtij sistemi është ajo ngjyrë që ia jep fuqinë për zgjidhjen e problemeve tokësore dhe lloj-lloj të mundshme, ngjyrë e cila hap horizont për angazhimin e logjikës (ixhtihadit) në

Seebachersfasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

nxerrjen e dispozitave aty ku nuk ka tekst burimor në metodën e analogjisë (kijasit) dhe metodat e tjera nga burimet e Sheriatit (jurisprudencës islame).

- Përgjithshmëria e këtij sistemi është ajo ngjyrë e cila e veçon nga të gjitha ngjyrat njerëzore që kanë qëllime të caktuara. Sistemi islam është sistem i Të Gjithëdijshmit i njohur me çështjet njerëzore, me ato që u përshtaten dhe me ato që u sjellin dëm. Për këtë arsye Islami është sistem i vetëm që ka aftësi për t'i përmbushur të gjitha nevojat njerëzore individuale dhe shoqërore, juridike dhe edukative. "Kjo fe jona është ngjyrosje e All-llahut, e kush ngjyros (me fe) më mirë se All-llahu ?!!" (Bekare, 138).

Derisa unë besoj se ardhmëria i takon Islamit, duhet të jem i bindur se të gjitha sistemet njerëzore janë të papërshtatshme për njeriun, për atë arsye edhe do të treten. Prej tyre socializmi me komunizmin, gjithashtu kapitalizmi me demokracinë për shkak të përkufizimit, paaftësisë, mangësisë dhe përkohshmërisë së tyre. Pikërisht këto sisteme e çuan në humbje, i prishën marrëdhëniet familjare dhe ato shoqërore, e shkatërruan moralin dhe i humbën vlerat e tij.U dhanë vend frikës dhe trazirave në vend të rehatisë dhe stabilitetit. U dhanë hapësirë egoizmit dhe dashurisë ndaj vetes në vend të ndihmës ndërnjerëzore dhe dashurisë ndaj njerëzve.

- Në sferën ekonomike

Sistemet kapitaliste dhe ato socialiste nuk arritën ta krijojnë parajsën të cilën e premtonin. Ndërsa për shoqërinë me bollëk dhe drejtësi për të cilën propagandojnë, në të dy sistemet lindën problemet e luftës ndërmjet klasave, duke u shtuar monopoli e duke u shtypur populli, dhe ja, ditë për ditë varfëria dhe destabilizimi po shtohen, kurse problemet tjera nuk kanë fund.

المؤسسة الإسلامية للشباب
Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth
Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
+41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

- Në sferën politike

Të gjitha sistemet demokratike, ushtarake, republikane, mbretërore, parlamentare, mbajnë përgjegjësinë e këtij destabilizimi dhe devijimi politik. Shfrytëzimet, favorizimet, mbizotërimet, gjithashtu kurthet e ndryshme, vrasjet revolucionet, atentatet, e kane tjollosur formulën e këtyre sistemeve njerëzore.

- Në sferën ushtarake

Gjithashtu, këto sisteme mbajnë përgjegjësinë e liqupërdorimit edaj popullatës së dehët islamu siç është çështja e Kashmirit, Etiopisë, Eritrisë, Filipineve, (tek ne çështja e Kosovës) dhe çështja e Palestinës në formë të veçantë, duke bërë tregti me të dhe duke e shfrytëzuar më sepër se 25 vjet. Ata pengojnë çdo përgatitje shpirtërore dhe fizike me të cilat populli islam do ta shporrte okupatorin kudo qoftë dhe do të çlirohej nga krimet e Izraelit.

Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

TË JEM MUSLIMAN NË FAMILJE DHE NË SHTËPINË TIME

Mbështetja ime në Islam më bën ithtar të këtij misioni, aq më repër të jetën time e vë në shërbim të këtij misioni. Nëse mbështetja ime në Islam më obligon të jem musliman në besimin tim, ibadetin tim dhe në moralin tim, atëherë pa dyshim obligohem të veproj që shoqëria jonë të jetë muslimane. Interesimi për të tjerët, duke i thirrur në Islam dhe duke i këshilluar, është ajo veçori që e dallon Islamin dhe gjurmët që mbeten në shpirtin njerëzor. Prandaj, Muhammedi

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zurich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

alejhis-selam thotë:"Kush bie në gjumë dhe nuk e ka interesuar çështja e muslimanëve, ai nuk u përket rradhëve të tyre". Nga ky hadith kuptojmë se ne kemi përgjegjësi për bartjen dhe kumtimin e Islamit në ummetin islam, por edhe gjetiu.

Hapi i parë në këtë drejtim duhet, të jetë shtëpia ime (kjo bashkësi e vogël) muslimane. Kjo ishte metoda që e përdori i dashuri ynë, Muhammedi alejhisselam në fillim ta da'ves (thirrjes islame): "Pra, përpos All-llahut mos lut zot tjetër e të bëhesh prej të dëmtarve dhe tëshiqja sërrjetjen farefisit tënd më të afërt. E të jeshë i butë ndaj besimtarëve që të pranuan ty". (Shuara, 213-215). Pra, hapi i parë që duhet ta ndërmarrë individi njusimtan është bëgat ta e shtëpisë sëtij në pajtim me sjelljet islame dhe udhëzimet e tyre:"O ju që besuat, ruane veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë zjarrin e nobkëcyrin engjejtë trepzë e të ashpër që nuk e kundërshtojnë All-llahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruar". (Tahrimë, 6).

Përgjegjësia e martesës

Islami na ka udhëzuar për formimin e shtëpisë muslimane dhe ate duke përcjellë një grup faktorësh që do lehtësonin në këtë:

1. Të jetë martesa ime vetëm për hir të All-llahut, të themeloj shtëpi muslimane dhe të kem pasardhës të pastër "Që janë pasardhës njëri prej tjetrit" (Ali Imran, 34).

2. Të jetë qëllimi im i martesës, ulja e shikimit, mbrojtja e ndërit dhe frika nga All-llahu. Këtë na e vërteton hadithi i Pejgamberit alejhis-selam:"Detyrë e All-llahut është që tre personave t'ju ndihmojë: Atij që përpiqet dhe mundohet në rrugë të All-llahut (muxhahidit), robit që lirohet me

المؤسسة الإسلامية للشباب
Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth
Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
+ 41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

shpagim të shtyer dhe punon me qëllim që ta kthejë dhe atij që martohet me qëllim që të mbetet i pastër (në nder)"(Tirmidhiu). Gjithashtu hadithi:"Kush martohet, veç e ka plotësuar gjysmën e fesë së tij, pastaj le t'ia ketë frikën All-llahut në gjysmën tjetër".(Taberaniu në Evsat).

3. Ta zgjedh bashkëshorten time sipas eshit tim, sepse Muhammedi alejhisselam ka thënë:"Zgjedhni bashkëshorten nga eshi juaj, sepse prejardhjet janë të kundërta",(Ibni Maxhe).

4. Ta zgjedh atë që ka moral dhe fe edhe në qoftë se ndoshta pasuri dhe bukuri; duke pastë parasysh thënien e Resulull-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem:"Mos i martoni gratë për bukuritë e tyre se ndoshta bukuria u ik, dhe mos i martoni për pasuritë e tyre se ndoshta pasuria tretet, por martoni për fenë e tyre; Një robëreshë e leckosur dhe flokëprishur është më e vlefshme nëse është fetare".(Ibni Maxhe).

5. Të kem kujdes që të mos e shkel urdhrin e All-llahut në martesë. Pejgamberi alejhisselam thotë:"Kush marton një grua vetëm për pozitën e saj, All-llahu e nënçmon; kush e marton vetëm për pasurinë e saj All-llahu e varfëron e kush e marton vetëm për farefisin e saj, All-llahu e poshtërson; e kush e marton vetëm për ta ulur shikimin e vet dhe për ta mbrojtur nderin e vet ose për ta shtuar familjen e vet, All-llahu i jep bereqet atij me të dhe i jep bereqet asaj me të".(Taberaniu)

Përgjegjësia pas martesës

Përgjegjësia pas martesës është kusht. Këtu paraqiten edhe detyra të reja, e nga ato janë:

1. Të jem i sjellshëm me bashkëshorten time, siç thotë Resulull-llahu alejhisselam:"Më i mirë prej jush është më i miri në familjen e tij, e unë jam më i miri prej jush në familjen time",(Ibni Maxhe

المؤسسة الإسلامية للشباب
Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth
Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ +41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

dhe Hakimi). Gjithashtu "Besimtari më i përkryer me iman është më i sjellshmi në moral dhe më i buti në familjen e tij".(Tirmidhiu)

2. Të mos kufizohen marrëdhëniet e mia me të vetëm si marrëdhënie intime, por pikësëpari duhet të realizohet bashkimi mendor, shpirtëror dhe emocional. Lexojmë bashkë..., i kryejmë disa ibadete bashkë..., i rregullojmë dhe i kryejmë nevojat shtëpiake bashkë..., pastaj lëmë pak kohë edhe për argëtim dhe lojë.

Në sferën e ibadetit I Lartmadhërishmi thotë:"Ai urdhëronte familjen e vet me faljen e namazit dhe me zeqat, dhe ishte shumë i pranishëm te Zoti i tij".(Merjem, 55). Ndërsa në sferën e argëtimit Pejgamberi alejhisselam bëri garë vrapimi me të shoqen Aishen radijall-llahu anha, ndërsa në sferën e ndihmës shtëpiake, Pejgamberi alejhisselam ishte gjithmonë në shërbim të familjes së vet dhe i arnonte këpucët e veta.

3. Marrëdhënia ime me bashkëshorten time duhet ta fitojë vetinë fetare, pra të mos jetë në kundërshtim me Islamin apo në atë se çka e ka ndaluar All-llahu, siç thotë Pejgamberi alejhisselam:"Çdo kush që respekton pasionet dhe emocionet e gruas (në ndalesa) All-llahu do ta hedhë në zjarr". Gjithashtu "Është lodhur dhe është mërzitur robi i gruas".

Përgjegjësia e përbashkët në edukimin e fëmijëve

Zgjedhja e gruas së ndershme dhe bashkimi i bashkëshortëve në kopshtin islam, ndihmon pa masë në edukimin e fëmijëve, me edukatë vërtet islame. Ndërsa, mosrealizimi i martesës islame sjell pasoja shkatërrimtare dhe mjeruese. Çdo mosmarrëveshje që ndodh ndërmjet bashkëshortëve reflektohet në jetën e fëmijëve të tyre që d.m.th. se edukimi i tyre ka lidhje të

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
+ 41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

ngushtë me sjelljet e prindërve të tyre dhe për këtë arsye, faktori i parë në edukimin islam të fëmijëve është realizimi i martesës islame siç cekëm më lart.

Fryti në të cilin shpresojmë, është formimi i pasardhësve të shëndoshë dhe të ndershëm."Zoti ynë, na bën që të jemi të gëzuar me (punën) e grave tona dhe pasardhësve tanë, e neve na bën shembull për të devotshmit". (Furkan, 74). Fëmija lindet në natyrshmërinë e tij, në qoftë se i jepet edukata e shëndoshë bëhet i mirë dhe i mirësjellshëm, e në qoftë se trijet në ndonjë mjedis joislam ndodh e kundërta. Pejgamberi alejhisselam thotë:"Çdo fëmijë lind në natyrshmërinë e tij, pastaj prindërit e çifutizojnë, e krishterojnë ose e bëjnë zjarrputis (besimi i jashtë persian)".(Buhariu dhe Muslimi) Për këtë arsye i dha rëndësi të veçantë edukimit të pastër islam. Në një rast Muhammedi alejhisselam tha:"Ta edukojë njeriu fëmijën e vet është me mire, se sa të ndajë sadaka me saë (masë e vjetër arabe)".(Tirmidhiu) Gjithashtu:"Nderoni (jepnu dhurata) fëmijët tuaj dhe zbukuroni sjelljet e tyre"(Ibni Maxhe). Pastaj, thënia e tij:"Kur vdes biri i Ademit, ndërpriten veprat e tij përveç në tre raste; Sadakaja që rrjedh, dituria që ka dobi prej saj dhe fëmijët e sjellshëm që luten për të"(Muslimi).

TIMBIZOTËROJ EMOCIONET E MIA

Lufta e njeriut me emocionet e veta është betejë e vështirë: "Pasha njeriun dhe Atë që e krijoi atë! Dhe ia mësoi cilat jane punë te keqija e cilat të mira. Pra, ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten. E, ka dështuar ai, që e poshtëroi vetveten". (Shems, 7, 10). Edhe Pejgamberi alejhisselam na e tërheq

Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth
Seebuchstrasse 67
CH-8052 Zürich
+ 41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

vëmendjen në betejë dhe thotë:"Ju paraqitën fitnet zemrave dhe i frikësojnë hiç pa ndalur, derisa disa zemra i pranojnë dhe u shënohet një pikë e zezë, e disa të tjera i refuzojnë dhe ju shënohet një pikë e bardhë. Pastaj zemrat shndërrohen ose në të bardha si uji i kthjellët dhe fitnet nuk i dëmtojnë, ose në të zeza e të mjegulluara kështu që nuk mund ta dallojnë të mirën dhe nuk mund ta dallojnë të keqen".

- Njerëzit që janë në luftë të përhershme me emocionet janë në 3 kategori:

1. Një grup u është nënshtruar epsheve të tyre. Ata janë gafirët (pabesimtarët) dhe kush shkon rrugës së tyre. All-llahu i Lartësuar i përshkruan në Kuranin e Tij: "Dhe [Muhammed] a ke parë ai (Muhammed) atë që duke e ditur dëshirën e vet e respekton si zot të vetin, atë All-llahu e ka humbur, e ka mbyllur të dëgjuarit dhe zemrën e tij, ka vënë perde para syve të tij. Me thuaj, pos All-llahut, kush mund ta udhëzojë atë? A nuk merrni mësim?" (Xhathije, 23).

2. Grupi tjetër luftojnë me emocionet e veta. Ndonjëherë fitojnë e ndonjëherë dështojnë. Gabojnë, por edhe pendohen. "Edhe ata të cilët kur bëjnë ndonjë (mëkat) të shëmtuar ose i bëjnë dëm vetvetes, e përmendin All-llahun dhe kërkojnë falje për mëkatet e tyre, e kush i falë mëkatet përveç All-llahut? Dhe që duke e ditur, nuk vazhdojnë në atë që kanë punuar (në të keqen)". (Ali Imran, 135).

3. Në grupin e tretë janë, ata që e fituan betejën me emocionet dhe i nënshtruan në tërësi për hir të All-llahut të Lartësuar. Ky grup gjendet në kategorinë më të lartë dhe më të emuar. Pejgamberi alejhisselam na e përshkruajti këtë grup në hadithin e vet: "Çdo bir i Ademit është gabimtar, por prej gabimtarëve më të mirë janë ata që pendohen (dhe nuk e përsërisin të njëjtin)". (Ahmedi dhe Tirmidhiu).

الموسسة الإسلامية للشباب
Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth
Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ +41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
✉ islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

Elementet e fitores në betejën me emocionet

1. Zemra e pastër dhe e kthjellët, siç thotë Aliu radijall-llahu anhu:"All-llahu azze ve xhel ka lënë në tokë butësi, e ato janë zemrat. Zemra më e dashur te Ai është ajo më e buta, më e pastra dhe më e qëndrueshmja d.m.th. më e qëndrueshmja në fe, më e pastra në bindje dhe më e buta me vëllezër" dhe fjala e tij: "Zemra e besimtarit është pa njolla, në të ka qiri që shndrit, ndërsa zemra e qafirit është e zezë dhe e mbrapshtë",(Ahmedi dhe Taberaniu). All-llahu Kur'anin për zemrën e besimtarit thotë:"Besimtarët të vërtetë janë vetëm ata të cilët kur përmendet All-llahu u rrëqethen zemrat e tyre", (Enfalë, 2). Ndërsa zemrat e pabesimtarëve i përshkruan:"Psë, ne të vërtetë e të nuk verbohen, por varfërohen zemrat në kraharor" (Haxhxh, 46), dhe thotë: "A nuk e studiojnë me vëmendje Kur'anin? Por jo, ato janë zemra që kanë dhe ne vëra", (Muhammed, 24).

2. Mendja e aftë, largpamëse dhe dalluese. Ajo është bazë e fjalës së All-llahut: "Po, All-llahut ia kanë frikën nga robërit e tij vetëm dijetarët", (Fatir, 28). Edhe Pejgamberi alejhisselam e cilësoi vlerën e mendjes kur tha:"S'ka krijesë që e krijoi All-llahu dhe e nderoi më shumë se atij që ia dha mendjen". Për këtë arsye Islami na drejton nga dituria, njohuria dhe studimi i fesë ashtu që zemra të përfitojë atë fuqi për ta dalluar të vërtetën nga lajthitja. Pejgamberi alejhisselam thotë:"Atij që dëshiron All-llahu t'i sjellë dobi i jep dituri fetare", (Buhariu) dhe shton:"Vlera e dijetarit ndaj injorantit është si vlera i me ndaj sahabiut (shokut) tim më të thjeshtë" (Tirmidhiu).

Mendja e besimtarit është mendje e ngritur dhe dalluese, sepse ai shikon në të me nurin e All-llahut edhe pas perdes: "Atij, të cilit All-llahu nuk i jep dritë, ai nuk ka për të pasur dritë" (Nur, 40) Këtë nur nuk e shuan asgjë përveç mëkateve dhe zhytjes në to, siç thotë Pejgamberi alejhisselam: "Kush bën një mëkat, i largohet një pjesë e të menduarit të shëndoshë dhe nuk i kthehet

المؤسسة الإسلامية للشباب
Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth
Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
+ 41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

kurrë". Gjithashtu:"Sikur të mos ishin djajtë ti rrethonin zemrat e bijve të Ademit, do të shikonin në madhërinë e qiejve dhe të tokës". (Ahmedi)

Dukuritë e disfatës së emocioneve

Kur njeriu pëson disfatë në betejën me djallin, atëherë atij i hapen dyert e të këqijave në shpirtin e tij, sepse djalli qarkullon në trupin e njeriut siç qarkullon gjaku.

Kur njeriut i humbë qëndresa shpirtërore djalli i bëhet shok."Ata i ka nënshtruar djalli dhe ua ka hedhur në harresë porositë e All-llahut". (Mujahideja, 19). "Ti kurrë nga Rrëfehuni mua. Më humbë, unë do t'ju ulem atyre (do t'ju zë pusi) në rrugën Tënde të drejtë. Mandej do t'ju sulem atyre para, prapa, nga e djathta dhe nga e majta e tyre, shumicën e tyre nuk do ta gjesh që ta ka falënderohen (të besojnë)!" (A'rafe, 16,17).

Sëmundja më e rrezikshme që e godet këtë njeri është vesvesja. Pejgamberi alejhisselam thotë:"Djalli i qëndron birit të Ademit në shumë rrugë; qëndron në rrugën e Islamit dhe i thotë: A po bëhesh musliman dhe po e lë fenë tënde dhe fenë e gjyshërve tu?-Nuk e dëgjoi dhe u bë musliman. Pastaj qëndroi në rrugën e xhihadit dhe i tha: A po shkon në xhihad ta humbish shpirtin dhe pasurinë, të luftosh e të vritesh, e pastaj të të martohen gratë e të të ndahet pasuria? Nuk e dëgjoi dhe bëri xhihad. Pastaj Pejgamberi alejhisselam tha: "Kush vepron dhe vdes kështu, është detyrë e All-llahut ta çojë në Xhennet". (Nesaiu)

Faktorët e mbrojtjes nga dyert e djallit

المؤسسة الإسلامية للشباب
Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth
Seebachersfrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

Islami e udhëzoi njeriun në mënyrat e mbrojtjes në betejën e tij me djallin. Njëri nga dijetarët e devotshëm i ka përmbledhur në thënien e tij:Shikoja dhe mendoja se prej cilës derë hyn djalli te njeriu, pastaj e pashë se ai hyn nga dhjetë dyer:

1. Nxitjes dhe keqkujtimit, por e përballova me bindje dhe kënaqësi.

2. Dashurisë ndaj jetës (në këtë botë) dhe shpresës së gjatë, por e përballova me frikën e vdekjes së papritur.

3. Kërkesës së qetësisë dhe të levërdisë, por e përballova duke kujtuar se levërdia e ka fundin, kurse llogaria (para Zotit) është e rëndë.

4.Çudisë dhe të mahniturit, por e përballova me bamirësi dhe me frikë ndaj pasojave të rënda.

5.Nënçmimin e njerëzve dhe mosrespektimin e tyre, por u përballova duke e ditur hakun dhe nderin e tyre.

6. Zilisë, por e përballova me kënaqësi dhe mjaftueshmëri me ndarjen e All-llahut.

7. Punës për sy e faqe dhe lavdërimit ndaj njerëzve, por e përballova me sinqeritet.

8. Koprracisë, por e përballova duke e ditur se atë që e kanë njerëzit do të zhduket, e atë që e ka All-llahu, do të mbetet gjithmonë.

9. Mendjemadhësisë, por e përballova me modesti.

10. Lakmisë, por e përballova me bindje ndaj asaj që i takon All-llahut, kurse me devotshmëri (jolakmi) ndaj asaj që u takon njerëzve.

المؤسسة الإسلامية للشباب
Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth
Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
+41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

Mbrojtja më e mirë nga sherret e djallit është të përmendurit e All-llahut në çdo punë.

Nga Ebu Hurejre përcillet kjo ngjarje:"Janë takuar djalli i besimtarit dhe djalli i qafirit. Djalli i qafirit i majmë dhe i veshur mirë, ndërsa djalli i besimtarit i praskapitur, i pluhurosur dhe i zhveshur. E pyeti djalli i qafirit djallin e besimtarit: Pse je kështu i dobët? Iu përgjigj: Unë jam me një njeri i cili kur han e përmend All-llahun e unë mbetem i uritur; kur pin ujë e përmend All-llahun e unë mbetem i etshëm, kur vishet e përmend All-llahun e unë mbetem i zhveshur, kur i rregullon flokët e përmend All-llahun e unë mbetem flokëprishur. Djalli i qafirit ia ktheu: Unë jam me një njeri që nuk vepron asnjëherë kështu, kur ai shqetësohet, unë e shqetësoj pa pikë faji veshmbathje".

Njëri prej faktorëve të mbrojtjes është edhe kujdesi nga ngrënia e tepërt dhe mbushja e barkut, edhe në qoftë se është hallall (e lejuar) dhe e pastër:"Hani dhe pini e mos e teproni, se Ai (All-llahu), nuk i do ata që e teprojnë (shkapërderdhin)",(A'rafë, 31), dhe fjala e Pejgamberit alejhisselam:"Djalli qarkullon në njeriun siç qarkullon gjaku, prandaj ngushtoja vendqarkullimet me uri".(Ahmedi)

Gjithashtu leximi i Kur'anit dhe përmendja e shpeshtë All-llahun, duke kërkuar falje (istigfarë), siç thotë Pejgamberi alejhisselam:"Djalli vë zorrën e tij në zemrën e birit të Ademit. Nëse ai e përmend All-llahun largohet, por nëse e harron All-llahun, e gëlltit zemrën e tij".(Ibn Ebu Dunija)

Po ashtu mosnxitimi dhe maturia në punë sepse Muhammedi alejhiselam ka thënë:"Të shpejtuarit është prej djallit ndërsa maturia (në punë) është prej All-llahut".(Tirmidhi)

الـمؤسسة الإسلامية للشباب
Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth
Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ +41 (0) 43 300 16 70
www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

kur thotë:"Vërtet, ata që janë të vuajtur, kur i prek ndonjë iluzion nga djalli, ata përkujtojnë (All-llahun), dhe atëherë shohin (të vërtetën)".

Vëlla musliman,

Pas leximit të kësaj shkrese nuk të mbetet asgjë përveç që të punosh për Islamin dhe të jeshë njëri prej atyre që e dëgjojnë fjalën e mirë, kurse e zbatojnë edhe më mirë. Mos harro se ti je duke jetuar në një kohë të ngarkuar përplot fitne e provokime, ndërsa riuga e shpëtimit është udhja për litarin e fortë të All-llahut dhe Rrugën e Tij të dreitë.

المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondacioni i Rinisë Islame

Stiftung der Islamischen Jugend

Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch